

**Akt themelimi**  
**i**  
**Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar**  
**"SI.SI-AI" SH.P.K**



Sot me date 16/01/2007 Stefan Çaçi, vendosi te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "SI.SI-AI" SH.P.K ne te cilen ai eshte ortak i vetme dhe per kete qellim harton kete Akt Themelimi me permbajtje si vijon :

**Neni 1**

**Emri**

Shoqeria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar emertohet "SI.SI-AI" SH.P.K dhe me poshte do te quhet "Shoqeria".

**Neni 2**

**Forma**

Kjo Shoqeri eshte nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

**Neni 3**

**Baza Juridike**

Shoqeria krijohet ne baze te Legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne perputhje me kete legjislacion dhe me normat e ketij Akti dhe te Statutit te vet. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

A large, stylized handwritten signature in black ink, located at the bottom left of the page.



#### **Neni 4**

##### **Selia**

Selia e Shoqerise eshte ne Rruga Gjin Bue Shpata, Pall 2/1, Apartamento 6/3, Tirane. Shoqeria mund te ndryshoje Seline me vendim te ortakut te vetem.

Shoqeria do ta konsideroje qendren e vet si Shoqeri Nene, e cila rast pas rasti do te hapet me ane filialesh ose Shoqerish te perbashketa ne te gjitha ato vende ku do te shikojte interes ne permbushjen e qellimit te saj, ne te gjithë territorin e Shqiperise ose dhe jashte saj.

#### **Neni 5**

##### **Territori**


Shoqeria e zhvillon aktivitetin si ne territorin e Shqiperise ashtu dhe jashte saj. Shoqeria mund te krijojte dege (filiale), ose perfaqesi ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise ashtu dhe ne Shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkatese.

#### **Neni 6**

##### **Objekti**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte kryerja e ketyre veprimeve tregtare:

Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj;  
Projektme, ndertime dhe asfaltme rrugesh dhe autostradash, ndertime dhe projektme urash dhe mbikalimesh  
Projektme dhe ndertime hidrocentralesh, sisteme prodhimi dhe transmetimi te energjise elektrike dhe cdo sistemi tjeter prodhimi energjie elektrike  
Projektim dhe ndertim sistemesh te ujit te pijshem  
Menaxhim te ujerave te zeza dhe kanalizimeve  
Punime ndertuese dhe riparuese portesh detare dhe marine, cdo lloj punime ne lidhje me makinerite dhe pajisjet e trajtimit te mallrave dhe njerzve ne porte dhe aeroporte  
Ndertime projektme dhe menaxhime te sitemeve te vaditjes, kanaleve rezervuareve dhe aksesoreve ndihmes.  
Ndertime civile dhe ekonomike. Ndertime civile, industriale, turistike, etj mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to;  
Ndertime civile me materiale me baze druri  
Punime karpenterie druri dhe metalike;



Punimet e montimit dhe teknologjike. Montimi dhe instalimi I makinerive dhe impianteve ngritese e transportuese (vinca, teleferik, transportiere, shkalle levizese, ashensore) etj dhe mirembajtja e tyre. Montimi dhe instalimi I impianteve termike, te ventilimit dhe kondicionimit te ajrit dhe mirembajtja e tyre. Montimi dhe instalimi I impianteve higjenike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare dhe mirembajtja e tyre. Punime me metal, dru, xham, plastike etj te impianteve teknologjike. Punime bojatisjeje, hidroizolimi, termoizolimi, akustik dhe kundra zjarrit te impianteve teknologjike;

Punime sherbimi te zakoneshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtjeje. Punime ne siperfaqet e gjelbera, parqe, pyje, lulishte. Pastrimi I siperfaqes urbane. Mirembajtja dhe zhvillimi I dekorit ne mbjedise urbane;

Punime topogjeodezike ne objekte inxhinierike, rilevime topografike si dhe punime speciale gjeodezike (rrjeta mbeshtetese gjeodezike ne kadastrim, qendrueshmeri objektesh etj);

Projektme; Studime pjesore urbanistike. Projektme objektesh civile, industriale dhe turistike deri ne pese kate dhe mbi pese kate. Projektme objektesh sportive. Projektme interieresh, sistemimesh siperfaqe te gjelbra, lulishte, parqe;

Import-Eksporti I materialeve te ndertimit, te gatshme apo gjysme te gatshme;

Import-Eksporti I materialeve te gatshme apo gjysme te gatshme per ndertimin e shtepive apo te llojeve te tjere te ndertimit me materiale drusore dhe materiale me baze druri;

Mbledhja, trajtimi dhe procesimi i mbeturinave me material te ngurte.


Shoqeria mund te kryeje edhe cdo lloj aktiviteti tjetër ndihmes dhe te nevojshem qe ka lidhje te mjaftueshme me kete objekt aktiviteti dhe qe nuk bie ndesh me ligjet shqiptare ne fuqi.

## Neni 7 Kohezgjatja

7.1 Shoqeria do ta zhvilloje aktivitetin e vet per nje afat te pacaktuar.

## Neni 8 Kapitali themeltar

8.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njqindmije). Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku I vetem.



**Neni 9**  
**Kontributet**

9.1 Kapitali themeltar perbehet nga kontributet e ortakut te vetem te shoqerise qe perfaqesojne 100% e kapitalit Themeltar, te depozituara te gjitha keto ne Banke.

**Neni 10**  
**Pjeset e kapitalit themeltar**

10.1 Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese plotesisht te shlyera, secila me vlere 1000 leke, te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100. Te gjitha pjeset I takojne Stefan Çaçi.

**Neni 11**  
**Administrimi**

11.1 Administrimi i Shoqerise do te behet nga nje Administrator. Administrator i Shoqerise eshte ortaku I vetem I shoqerise Z. Stefan Çaçi, shtetas shqiptar, i biri I Nikolles, dhe I Ines, i datelindjes 19/03/1988, me numer pasaporte Z 1229686 , me adrese ne Rruga Gjin Bue Shpata, Pall 2/1, Apartamenti 6/3, Tirane.

**Neni 12**  
**Dispozita te Fundit**

Shoqeria do te rregullohet, pervec ketij akti themelues dhe me norma te percaktuara ne Statutin e saj, i cili do te nenshkruhet nga ortakut dhe si i tille do te miratohet ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, ne ditën e legalizimit si person juridik ne Shqiperi.

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 4 egzemplare, ne gjuhen Shqipe, secila me fuqi te njejte ligjore.

**Themeluesi**  
**Stefan Çaçi**



**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"SI.SI-AL" sh.p.k**



**Titulli I**  
**Emertimi – objekti**  
**Selia – kohezgjatja**  
**Neni 1**

Eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin e shoqerise "SI.SI-AL" Sh.P.K.

**Neni 2**

Objekti I aktivitetit te shoqerise "SI.SI-AL" sh.p.k eshte :

Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj;

Projektime, ndertime dhe asfaltime rruges dhe autostradash, ndertime dhe projektime urash dhe mbikalimesh

Projektime dhe ndertime hidrocentralesh, sisteme prodhimi dhe transmetimi te energjise elektrike dhe cdo sistemi tjeter prodhimi energjie elektrike

Projektim dhe ndertim sistemesh te ujit te pijshem

Menaxhim te ujerave te zeza dhe kanalizimeve

Punime ndertuese dhe riparuese portesh detare dhe marine, cdo lloj punime ne lidhje me makinerite dhe pajisjet e trajtimit te mallrave dhe njerzve ne porte dhe aeroporte

Ndertime projektime dhe menaxhime te sitemeve te vaditjes, kanaleve rezervuareve dhe aksesoreve ndihmes.

Ndertime civile dhe ekonomike. Ndertime civile, industriale, turistike, etj mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to;

Ndertime civile me materiale me baze druri

Punime karpenterie druri dhe metalike;

Punimet e montimit dhe teknologjike. Montimi dhe instalimi I makinerive dhe impianteve ngritese e transportuese (vinca, teleferik, transportiere, shkalle

levizese, ashensore) etj dhe mirembajtja e tyre. Montimi dhe instalimi I impianteve termike, te ventilimit dhe kondicionimit te ajrit dhe mirembajtja e tyre.

Montimi dhe instalimi I impianteve higjenike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare dhe mirembajtja e tyre. Punime me metal, dru, xham, plastike etj te impianteve teknologjike. Punime bojatisjeje, hidroizolimi, termoizolimi, akustik dhe kundra zjarrit te impianteve teknologjike;



**Punime shërbimi të zakonshme të sistemit komunal dhe punime mirëmbajtjeje.**  
**Punime në sipërfaqet e gjelbra, parqe, pyje, lulishte. Pastrimi I sipërfaqes urbane.** Mirëmbajtja dhe zhvillimi I dekorit në mbjedise urbane;  
**Punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, rievime topografike si dhe punime speciale gjeodezike (rrjeta mbështetese gjeodezike në kadastrim, qendrueshmeri objektësh etj);**  
**Projektme; Studime pjesore urbanistike. Projektme objektësh civile, industriale dhe turistike deri në pesë kate dhe mbi pesë kate. Projektme objektësh sportive.**  
**Projektme interieresh, sistemimesh sipërfaqe të gjelbra, lulishte, parqe;**  
**Import-Eksporti I materialeve të ndërtimit, të gatshme apo gjysme të gatshme;**  
**Import-Eksporti I materialeve të gatshme apo gjysme të gatshme për ndërtimin e shtëpive apo të llojeve të tjera të ndërtimit me materiale drusore dhe materiale me baze druri;**  
**Mbledhja, trajtimi dhe procesimi i mbeturinave me material të ngurte.**  
**Shoqëria mund të kryejë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër ndihmes dhe të nevojshëm që ka lidhje të mjaftueshme me këtë objekt aktiviteti dhe që nuk bie ndesh me ligjet shqiptare në fuqi.**

#### **Neni 3**

Selia e shoqërisë "SI.SI-AL" sh.p.k do të jetë në Rrugë Gjine Bue Shpatë, Pall 2/1, Apartamenti 6/3, Tiranë.

#### **Neni 4**

Residenca ligjore e ortakut për çdo raport me shoqërinë është selia e shoqërisë.

#### **Neni 5**

Kohezgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

#### **Neni 6**

Shoqëria mund të krijojë degë apo përfaqësi të saj brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Titulli II**

#### **Katipitali shoqëror dhe kuotat**

#### **Neni 7**

Kapitali themeltar I shoqërisë përbehet nga kontribute në të holla me vlerë prej 100 000 (njëqindmijë) leke.



#### **Neni 8**

Kapitali themeltar eshte ndare ne 100 kuota secila me vlere te barabarte. Vlera e cdo kuote eshte 1000 leke dhe vlera e tyre eshte shlyer plotesisht nga ortaku i vetem i shoqerise. Kuotat e shoqerise zoterohen teresisht nga ortaku i vetem kuota qe I korespondojne 100% te kapitalit te Shoqerise.

#### **Neni 9**

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme, ne rruge trashegimie, ne raste ndarje te pasurise midis bashkeshorteve, ndermjet te paralindurve dhe te paslindurve.

Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen te treteve qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakeve te shoqerise.

### **Titulli III**

#### **Kompetencat e ortakut themelues**

#### **Neni 10**

Ortaku themelues i shoqerise ka kompetence :

Te miratoje programin e shoqerise,te hartoje raportin e administrimit ,inventaret,llogarite vjetore , te cilat pregatiten brenda afatit 6 mujor duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar;

Vendos per shperndarjen e shoqerise

Vendos per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;

Vendos per trasferimin e kuotave

Rregullon mardhenjet e punesimit e te shperblimit brenda shoqerise;

Shlyen detyrimet ndaj organeve shteterore si dhe personave juridike apo fizik vendas apo te huaj.

#### **Neni 11**

Te gjitha vendimet e rendesishme per ndryshimet ne statut merren me vendim te ortakut te vetem te shoqerise. Shtimi I numrit te ortakeve behet me vendim te ortakut te vetem I cili ka te drejten te beje ndryshimet e nevojshme ne aktet e shoqerise dhe ta autorizoj administratorin te paraqese ndryshimet ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.



### **Neni 19**

Shperblimi per administratorin, tej shpenzimeve te ndodhura gjate kryerjes se detyrave normale te administrimit te shoqerise, do te percaktohet nga ortaku I vetem.

### **Titulli V**

#### **Kontrolli I ortakeve**

### **Neni 20**

Cdo ortak I shoqerise ka te drejte te marre njoftim nga administratori per kryerjen e puneve te shoqerise dhe te konsultohet me librat e shoqerise.

### **Titulli VI**

#### **Bilanci dhe mjetet**

### **Neni 21**

Cdo vit financiar fillon ne Janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor te cdo viti, duke perjashtuar vitin e pare I cili fillon ne momentin e regjistrimit te shoqerise. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecante te hartuara nga Administratori dhe eventualisht nga eksperte kontabel te autorizuar, miratohen nga ortaku I vetem I shoqerise. Miratimi I dokumentave mbi veprimtarine vjetore te Shoqerise behet brenda nje afati prej tre muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

### **Neni 22**

#### **Dividentet**

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimit, dhe pas zbritjes prej tij te shpenzimeve te kryera gjate administrimit si dhe te pages se administratorit apo drejtorit te ndermarjes tregtare, si dhe pas zbritjes nga ky fitim I vitit fiananciar te shumes per fondin rezerve (5 % te fitimit te cdo viti, derisa ky te arrije 1 /10 e kapitalit themeltar), cka ngelet do te jete fitim I ortakut te vetem.

### **Titulli VII**

#### **Prishja dhe likuidimi**

### **Neni 23**

Shoqeria priset ne te gjitha rastet e parashikuara nga ligji.





#### **Neni 24**

Shoqeria hyn ne likujdim ne momentin e prishjes se saj. Ortaku I vetem do te percaktoje modalitetet e likujdimit si dhe do te emeroje nje ose me shume likuidatore.

Likuidimi I shoqerise do te behet sipas dispozitave ligjore.

#### **Titulli VIII Mardheniet e punes Neni 25**

Mardheniet e punes midis shoqerise dhe te punesuarve do te percaktohen nga kontrata individuale dhe kolektive e punes. Per ato cka nuk parashikohet ne keto kontrata do te zbatohet legjislacioni ekzistues I punes.

#### **Titulli IX Kompetenca gjyqesore Neni 26**

Cdo mosmarehouse qe mund te linde lidhur me interpretimin e ketij statuti apo akteve te tjera te shoqerise, ose mosmarehouse qe mund te lindin gjate ushtrimit te aktivitetit te shoqerise do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast se ky nuk arrihet kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete gjykata e rrethit gjyqesor Tirane.

#### **Titulli X Dispozita te pergjithshme Neni 27**

Per ate cka nuk eshte thene shprehimisht ne kete statut do te referohet ne ligjin 7638, dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", Kodin Civil, si dhe ne ligje te tjera shqiptare.

Ky Statut hartohet ne kater egzemplare te gjithe te shkruar ne gjuhen shqipe dhe me fuqi te njejte ligjore.

**ORTAKU I VETEM  
DHE ADMINISTRATORI  
STEFAN ÇAÇI**